

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË KONFERENCËN E GJASHTË TË KOMISIONEVE PARLAMENTARE TË INTEGRIMIT EVROPIAN TË SHTETEVE PJESEMARRËSE NË PROCESIN E STABILIZIM-ASOCIIMIT TË EVROPËS JUGLINDORE**

*Tiranë, 9 mars 2012*

Zonja Kryetare,  
Deputetë,  
Ambasador Sequi,  
Të nderuar të ftuar,  
Mirëdita!

Jam shumë i lumtur që jam me ju sot për të diskutuar së bashku një temë thelbësore për lirinë, demokracinë dhe prosperitetin e rajonit në të ardhmen – integrimin evropian.

Dhe, si kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, nuk do të habiteni po t'ju them se ne i mbështesim plotësisht përpjekjet e Shqipërisë në rrugën e saj drejt procesit të integrimit evropian. Të njëjtën gjë bëjnë edhe kolegët e mi në misionet e OSBE-së në rajon.

Zonja Kryetare sapo theksoi se integrimi është një Përparësi Kombëtare për Tiranën.

Prezenca punon shumë ngushtë me Delegacionin e BE-së dhe me Këshillin e Evropës duke e ndihmuar Shqipërinë për zbatimin e një sërë projektsh strategjike kryesore për të adresuar një sërë përparësish të BE-së.

Kuptohet që roli që luajnë parlamentet kombëtare në çuarjen përpara të axhendës së integrimit është vendimtar.

Përgëzoj të gjithë të pranishmit që i bashkoni përpjekjet tuaja me ato të qeverive dhe parlamenteve tuaja në zbatimin e reformave në vendet tuaja.

Mendoj se fjala kyçe që duhet theksuar këtu është 'partneritet' dhe 'solidaritet'.

Mundësia për t'u bashkuar e atyre që kanë pikëpamje politike shpesh të ndryshme, për të arritur marrëveshje politike për çështje strategjike kryesore me interes kombëtar është absolutisht thelbësore për suksesin e integrimit.

Një rishikim i thjeshtë i historive të të gjitha vendeve të rajonit do të tregojë se në rastet kur partneritete të tilla nuk kanë qenë të mundura, sukcesi i axhendës së integrimit ka qenë i kufizuar.

Në të vërtetë, partneriteti nevojitet jo vetëm për miratimin e legjislacionit, por edhe për t'u siguruar se fjalët për të cilat bihet dakord në parlament zbatohen 'në terren' dhe ndihen në jetën e njerëzve të zakonshëm.

Nuk janë copëzat e mençura të letrave legjislative ato që sjellin ndryshimin, është zbatimi i tyre i plotë.

Prandaj edhe përgjegjësia që bie mbi shpatullat tuaja politike është kaq e madhe.

Përveç kësaj, kjo është edhe arsyeja pse unë besoj se konferenca e sotme ofron një mundësi të shkëlqyer për këmbim përvojash dhe idesh me qëllim shmangien e çdo lloj "rishpikjeje të rrotës".

Sa i përket Prezencës së OSBE-së, fokusi ynë qëndron tek Shqipëria, prandaj edhe unë do të vë në pah disa sfida me të cilat do të duhet të përballen qeveritë e të gjitha ngjyrave të politikës në këtë vend.

Së pari, më lejoni të përmend çështjen e drejtësisë dhe të reformës ligjore.

Duke qenë se një sistem gjyqësor funksional, si dhe besimi tek ky sistem, përbëjnë elementët kryesorë për një vend demokratik ku sundon shteti i së drejtës, reforma në drejtësi në përputhje me standardet evropiane është vendimtare për të gjitha vendet e rajonit.

Në këtë aspekt, është mbresëlënës orientimi i qartë si i qeverive, ashtu edhe i parlamenteve drejt legjislationit evropian dhe standardeve evropiane.

Për ta forcuar edhe më shumë këtë proces, do t'i inkurajonim të gjitha institucionet kombëtare përkatëse që t'i marrin vlerat evropiane themelore si një kornizë dhe t'i përshtatin ato me mençuri.

Së dyti, do të doja që të adresoja shkurtimisht çështjen e reformës zgjedhore – një fushë që qëndron pikërisht në zemër të asaj çka bën OSBE-ja dhe një temë që jam i sigurt se njihet nga shumica, në mos nga të gjithë të pranishmit këtu.

Jam mirënjohës që zonja Kryetare e trajtoi këtë temë në fjalën hyrëse.

Reforma zgjedhore në çfarëdoq vendi përbën një nga reformat më vendimtare për zhvillimin e mëtejshëm demokratik – për këtë mund të biem të gjithë dakord.

Është një proces kompleks që kërkon diskutime gjithëpërfshirëse në nivel politik dhe teknik.

Kjo është edhe arsyeja për të cilën them me kënaqësi se reforma është në proces e sipër në parlamentin shqiptar.

Shfrytëzoj rastin t'i inkurajoj fort të gjithë aktorët e interesuar që të mbështeten tek praktika pozitive aktuale.

Edhe një herë, i kthehem faktit se ekzistenca dhe vazhdimësia e vullnetit politik dhe besimit reciprok mes aktorëve kombëtarë është jetësore që reforma të finalizohet në mënyrë shteruese dhe në kohën e duhur.

Gjithashtu, është e rëndësishme që çdo reformë e një cilësie të lartë të ketë për zot vetë vendin që e bën atë.

Në fund, më lejoni të ngre edhe çështjen e reformës së pronës – një temë që ka rezultuar të jetë problematike në mos për të gjitha vendet e rajonit, për shumicën e tyre.

Kjo është sigurisht një çështje që e njohim mirë, pasi ajo është pjesë e mandatit tonë.

Aktualisht, legjislationi konfliktual dhe mungesa e vazhdueshme e harmonizimit e ka bërë reformën e pronës më të komplikuar, është bërë pengesë për zbatimin efikas të ligjeve dhe akteve të detyrueshme nënligjore, dhe ka vonuar proceset ligjore duke çuar në rënie të sigurisë ligjore.

Qeveria shqiptare duhet përgëzuar për nxjerrjen e versionit paraprak të Strategjisë së saj të reformës së Pronës.

Ne shpresojmë që Strategjia të përcaktojë politika që do të mundësojnë regjistrimin fillestar dhe përcaktimin e statusit ligjor të pronave.

Zonja kryetare,  
Të nderuar miq,

Sipas këndvështrimit tim, procesi i integritit evropian mund të jetë i suksesshëm vetëm nëse ka mbështetjen e qytetarëve të një vendi.

Nga ana tjetër, qytetarët mund të mbështesin këtë proces vetëm nëse qeveritë apo parlamentet përkatëse shpjegojnë procesin dhe të mirat e tij.

Duhet të them se përfshirja e shoqërisë civile dhe grupeve të specializuara përkatëse ndihmon për t'i shpjeguar në mënyrë efektive njerëzve të thjeshtë se për çfarë bëhet fjalë.

Për ta përmbledhur, mendoj se fjalët kyçe për të pasur sukses në të ardhmen janë partneritet, solidaritet kombëtar dhe komunikim.

Më lejoni t'u uroj të gjithë të pranishmëve një konferencë produktive – dhe duke pasur parasysh të gjithë personalitetet e shquara të mbledhur këtu sot, mendoj se s'ka si të jetë ndryshe.

Faleminderit!

**Fund**